


INDEKSI I ÇMIMIT TË PRODHIMIT PËR TREMUJORIN E DYTË 2007



Në tre mujorin e dytë të vitit 2007, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 103.7 për qind (Viti 2005 = 100), duke shënuar një rritje prej 1.3 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është 2.7 përqind.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në degën "Industri Përpunuese" shënoi ulje prej 6.4 përqind. Kjo industri ka dhe ndikimin më të madh në këtë indeks me 62.3 përqind. Brenda kësaj dege ulja me e madhe prej 6.2 përqind vërehet në nëndegën "Industri kimike".

Indeksi në nëndegën "Industri ushqimore" shënoi një rritje me 6.1 përqind. Ketu mund te përmendim rritjen e çmimeve të produkteve në aktivitetin "Industria e produkteve ushqimore dhe pije" me 6.3 përqind dhe çmimeve të produkteve në aktivitetin "Industria e duhanit" me 0.5 përqind.

Indeksi në nëndegën "Industri tekstile" indeksi shënoi një rritje prej 8.0 përqind,.

Në aktivitetet e tjera ndryshimet variojnë nga -2.0 në +3.4 përqind.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas (viti 2005 = 100) arriti 103.9 përqind duke shënuar një rritje prej 1.8 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm..

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport (viti 2005 = 100) arriti 102.8 përqind duke shënuar një ulje prej 2.0 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm.